



MBAHET NË TIRANË SAMITI I PROCESIT TË BERLINIT

Më 16 tetor 2023, Shqipëria u bë vendi i parë i rajonit që mirëpriti Procesin e Berlinit. Pjesëmarrësit në këtë event theksuan rëndësinë e bashkëpunimit rajonal në Ballkanin Perëndimor në kontekstin aktual të pasigurisë gjeopolitike dhe luftës në Evropë. Ata theksuan rëndësinë e forcimit të lidhjes së transportit, tregtisë, energjisë, dixhitalizimit në Ballkanin Perëndimor, si dhe midis rajonit dhe BE-së.



MINISTRI HASANI: RIGJALLËRIMI I PROCESIT TË INTEGRIMIT DUHET TË KONKRETIZOHET ME MASA TË PREKSHME

Më 6 tetor 2023, u mbajt në Tiranë takimi i Ministrave të Punëve të Jashtme të Procesit të Berlinit. Në konferencën për mediat pas takimit, Ministri Hasani vlerësoi përpjekjet e Ballkanit Perëndimor në zbatimin e marrëveshjeve për Tregun e Përbashkët Rajonal, teksa nënvizoi rëndësinë e bashkëpunimit rajonal për ndërtimin e qëndrueshmërisë ekonomike. Kryediplomati shqiptar zhvilloi takime dypalëshe me homologen e tij gjermane Annalena Baerbock, Ministrin e Jashtëm grek, Jorgo Gerapetritis, si edhe me Ministrin për Evropën e MB, Leo Docherty.



NJU JORK MINISTRI HASANI TAKIME TË NIVELIT TË LARTË NË KËSHILLIN E SIGURIMIT

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani, ka kryesuar takimin e posaçëm të formatit Arria të Këshillit të Sigurimit, ku me ftesën e Shqipërisë, Kosova përmes Presidentes Vjosa Osmani mbajti fjalën në tryezën më të lartë vendimmarrëse në botë. Ministri Hasani theksoi se dhuna seksuale e lidhur me konfliktin është një krim lufte dhe mbetet një sfidë thelbësore e sigurisë globale, teksa nënvizoi se bota mund të mësojë shumë nga Kosova lidhur me këtë çështje. Në takimin Debat i hapur i nivelit të lartë të Këshillit të Sigurimit të OKB, me temë: "Paqja përmes dialogut: Kontributi i marrëveshjeve rajonale, nën-rajonale dhe dypalëshe, në parandalimin dhe zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve" MEPJ Igli Hasani theksoi se sfidat aktuale gjeopolitike e bëjnë të domosdoshme bashkëpunimin mes OKB/KS dhe organizatave rajonale në ruajtjen e paqes dhe sigurinë ndërkombëtare. Ministri Hasani mori pjesë në takimin e KS për situatën në Lindjen e Mesme, ku dënoi sulmet ndaj Izraelit, teksa nënvizoi rëndësinë për rrjedhjen normale të ndihmës humanitare për civilët.



SHQIPËRIA ZGJIDHET PËR HERË TË DYTË ANËTARE E KËSHILLIT TË TË DREJTAVE TË NJERIUT TË OKB-SË

Pas votimit me 123 vota pro në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, Shqipëria u zgjodh anëtare e Këshillit të të Drejtave të Njeriut për periudhën 2024-2026. Objektivi kryesor i Shqipërisë do të jetë të punojë brenda Këshillit dhe sistemit të Kombeve të Bashkuara për të garantuar respektimin universal të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, për të gjithë individët pa diskriminuar askënd.



MINISTRI HASANI: KOSOVA PRIORITET ABSOLUT I POLITIKËS SË JASHTME TË SHQIPËRISË

MEPJ Igli Hasani, gjatë fjalës së tij në Kuvend për miratimin e projektrezolutës në mbështetje të Kosovës, theksoi se Kosova ka qenë dhe mbetet në qendër të aktivitetit diplomatik shqiptar. Kryediplomati shqiptar dënoi sulmin e 24 shtatorit në Kosovë, teksa nënvizoi se dialogu Kosovë-Serbi mbetet zgjidhja e vetme për tejkalimin e situatës së krijuar në rajon.



MINISTRI HASANI: GATI PËR KONFERENCËN E DYTË NDËRQEVERITARE SHQIPËRI-BE

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani, ka marrë pjesë në forumin e hapur me temë "Zhblokimi i progresit: E ardhmja evropiane e Ballkanit Perëndimor". Ministri Hasani theksoi se forcimi i bashkëpunimit strategjik mbetet e vetmja rrugë drejt integrimit evropian të rajonit, teksa nënvizoi rolin proaktiv të Shqipërisë në këtë drejtim.



SHQIPËRIA E PËRKUSHTUAR NDAJ FUQIZIMIT TË PARLAMENTARËVE TË RINJ

MEPJ Igli Hasani priti në një takim në MEPJ delagacionin e Asamblesë Parlamentare të OSBE të kryesuar nga Sekretari i Përgjithshëm, Roberto Montella. Ministri Hasani vlerësoi rolin e Asamblesë Parlamentare të OSBE në lehtësimin e dialogut ndërparlamentar, ndërsa rikonfirmoi përkushtimin e palëkundur të Shqipërisë në fuqizimin e parlamentarëve të rinj.